

AKT - THEMELIMI

PER KRIJIMIN E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ME ORTAK TE VETEM

"ROZAF A " SHPK

Mbeshtetur ne legjislacionin qe lejon dhe rregullon veprimtarite private ne Shqiperi, si edhe ne baze te vullnetit tim, vendosa te krijoj shoqerine tregetre me pergjegjesi te kufizuar me nje ortak te vetem, emertuar: **"ROZAF A " SHPK**, me qender prane Portit Detar Shengjin , Lezhe .

NENI 1

Kjo do te jete shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe me ortak te vetem themeluesin e saj Zi. MIMIKA LUCA.

NENI 2

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"ROZAF A " SHPK** te gjithe aktivitetin e saj do ta zhvilloje ne perputhje me ligjet Nr.7638 date 11.11.1992 "Per shoqerite tregetare" dhe Nr.7667 date 28.01.1993, si edhe me aktet e tjera nenligjore te nxjerra ne baze te ketyre ligjeve.

NENI 3

Qendra e aktivitetit te shoqerise do te jete prane Portit Detar Shengjin , Lezhe , Republika e Shqiperise. Ajo ka te gjitha te drejtat per te krijuar dege e filiale te saj ne cdo rreth te vendit si edhe jashte territorit te R. Shqiperise, me kusht qe te respektoje legjislacionin e shtetit respektiv.

NENI 4

Shoqeria ka te drejte te beje ndryshim te emertimit te saj duke marre nje emertim te ri. po ashtu ka te drejte te ndryshoje edhe qendren e aktivitetit nga ku eshte ne daten e sotme, por keto ndryshime do te behen vetem ne baze te rregullave dhe menyren e caktuar ne ligj dhe ne kete statut.

NENI 5

Pasi te jete kompletuar e gjithe procedura dhe te merret vendimi gjyqesor e te kryhet rregjistrimi ne zyren e Rregjistrimit Tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane, dhe ne organet perkatese tatimore, shoqeria do te filloje aktivitetin e saj ne fushen e percaktuar ne objektin e shoqerise.

NENI 6

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"ROZAF A " SHPK** ne objektin e veprimtarise se saj do te kete:



Importit , eksportit , tregimit me shumice dhe me pakice te artikujve te ndryshem industriale , ushqimore , bujqesore , blektorale , makineri e pajisje , automjete te te gjitha llojeve .Zenien ,perpunimin dhe tregimin me shumice dhe pakice te te gjitha artikujve te prodhimeve te detit brenda dhe jashte Shqiperise .Hapjen e ambienteve te bar - restoraneteve , hoteleri , e ambienteve per kryerjen e tregimit te mallrave . Investimin e fitimeve te shoqerise ne fonde te ndryshme ne Shqiperi dhe jashte saj.

NENI 7

Per realizimin e objektivave te shoqerise dhe per arritjen e rezultatit te deshiruar ekonomik, ortaku i vetem dhe themelues i saj Zj. Mimika Luca , cakton kapitalin fillestar te themelimit te shoqerise ne shumen prej 100 000 (njeqind mije) lekesh, shume e cila do te depozitohet ne nje nga Bankat e Tiranes.

NENI 8

Kapitali themelor i shoqerise mund te shtohet ne cdo rast kur shoqeria ka realizuar objektivat e saj dhe ka interes per zgjerimin e veprimtarise qe zhvillon, gjithmone brenda kuadrit te objektit te miratuar.

NENI 9

Po ashtu shoqeria ka te drejte te beje pakesim te kapitalit fillestar te saj, kjo ne rastet kur veprimtaria financiare e shoqerise ka tregues negative.

Ne rast se rezulton se humbjet ne shoqeri jane te konsiderueshme dhe kjo vertetohet me analiza ekonomiko - financiare, e ne vecanti kur ato jane me te medha se gjysma e kapitalit themelor, atehere ortaku krijues i shoqerise ben analizen e hollesishme duke vendosur edhe rruget e financimit te ketyre humbjeve. Kur nuk eshte e mundur te realizohet kjo, mund te vendoset edhe prishja e shoqerise.

NENI 10

Pakesimi i kapitalit themelor ne shoqeri lejohet deri ne masen e humbjeve financiare qe aktualisht kane mbetur dhe nuk ka mundesi te mbulohen me fondet e caktuara ne kete drejtim.

NENI 11


Krijuesi i shoqerise "ROZAFI" SHPK, ka te drejte te tjetersoje pjese te kapitalit te shoqerise ose gjithë shoqerine, duke respektuar kerkesat e ligjit Nr.7639 date 19.11.1999, si edhe dispozitat perkatese ne K.C. per kontratat.

NENI 12

Organi drejtues i shoqerise eshte:

- ADMINISTRATORI I SHOQERISE .

Procedura per caktimin e administratorit eshte e percaktuar ne statutin e shoqerise, dhe kete e vendos ne menyre individuale ortaku i vetem i shoqerise.



NENI 13

Qe ne momentin e themelimit te shoqerise, eshte vendosur qe administrator i saj te jete Z. Gjergj LUCA.

NENI 14

Administratori i shoqerise Z. Gjergj LUCA, ka te gjitha te drejtat per te udhehequr shoqerine, per ta perfaqesuar ate ne te gjitha aktivitetin e saj ekonomik, juridik, kontraktual dhe ne mardhenie me personat e punesuar.

NENI 15

Ortaku i vetem, ne drejtimin e shoqerise merr vendime te shkruara, te cilat jane te vlefshme me miratimin e tyre dhe kane karakter detyrues ne shoqeri, per te gjitha personat e punesuar aty.

NENI 16

Likujditetet dhe transaksionet financiare do te depoizitohen ne Bankat e Shqiperise ose jashte shtetit atje ku shoqeria ka qendren ose filiale te saj.

NENI 17

Per mbajtjen e llogarise dhe kapitalit themelor, shoqeria cel librin e llogarive ku do te kryhen shenimet e te gjitha levizjeve ne kapitalin themelor dhe ndryshimet e nevojshme te kryere ne te.

NENI 18

Shoqeria merr persiper dhe garanton respektimin e Ligjit per Kontabilitetin ne Shqiperi si edhe respektimin e informacioneve sipas ligjit.

NENI 19

Fitimet neto qe shoqeria do te realizoje gjate aktivitetit te saj mbeten ne pronesi te ortakut te vetem, Zj. Mimika Luca, e cila ka te drejten e administrimit dhe perdorimit te tyre sipas qellimeve te percaktuara nga ajo vete.

NENI 20

Shoqeria ka te drejte te punesoje shtetas shqiptare ose te huaj persona fizike sipas nevojave te shoqerise, duke krijuar me ta mardhenie punesimi.

Per kete arsye do te respektohet K.i Punes I Republikes se Shqiperise dhe legjislacioni mbi Sigurimet Shoqerore.



NENI 21

Ortaku i vetem ka te drejte te vendose per vazhdueshmerine ose jo te veprimtarise se shoqerise. Ne rast se vendos per prishje te shoqerise, ai vete cakton kohen dhe menyren e likujdimit te shoqerise, duke caktuar edhe komisionin e likujdimit si dhe likujdatoret.

NENI 22

Ne rast se midis krijuesit te shoqerise dhe personave te punesuar dalin mosmarrveshje, te dyja palet duhet te bejne perpjekje per zgjidhje te tyre me mirekuptim, e kur nje gje e tille nuk arrihet, palet kane te drejte te zgjidhin mosmarrveshjet ne rruge gjyqesore. Gjykata kopetente eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane

NENI 23

Te gjitha mosmareveshjet me te tretet shoqeria do te tentoje ti zgjidhe me mirekuptim. Ne pamundesi te zgjidhjes se tyre me mirekuptim Gjykata kopetente per zgjidhjen e mosmareveshjeve midis te treteve dhe shoqerise " ROZAF " sh.p.k. eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane

NENI 24

Dispozitat e aktit te themelimit jane te detyrueshme per tu respektuar si nga administratori i shoqerise dhe te gjithne personat e tjere qe kane lidhje pune me kete shoqeri.

NENI 25

Akti i themelimit redaktohet ne kater origjinale dhe pasi behet noterimi I tyre, se bashku me aktet e tjera, depozitohet nje kopje edhe ne Gjykate.

KRIJUESI I SHOQERISE

" ROZAF " SHPK

MIMIKA LUCA

Mimika Luca
[Signature]

STATUT

i

SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

ME NJE ORTAK TE VETEM

"ROZAFI" SHPK

KREU I

Dispozita te pergjithshme

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar, me nje ortak te vetem "ROZAFI" SHPK themelohet ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992, "Per shoqerite tregetare" dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993, "Per rregjistrimin ne rregjistrin tregetar", si edhe te gjitha aktet nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatim te ketyre ligjeve.

NENI 2

Shoqeria krijohet me ortak te vetem Zj. MIMIKA LUCA.
Qendra e selise te shoqerise tregetare "ROZAFI" SHPK eshte prane Portit Detar Shengjin .
Lezhe .

NENI 3


Gjate veprimtarise se saj , shoqeria ka te drejte te krijojë dege dhe filiale ne qytete dhe rrethe te tjera te vendit si edhe jashte shtetit, duke respektuar legjislacionin e shtetit perkates.

NENI 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "ROZAFI" SHPK eshte :
"Importit , eksportit , tregetimit me shumice dhe me pakice te artikujve te ndryshem industriale , ushqimore , bujqesore , blektorale , makineri e pajisje , automjete te te gjitha llojeve .Zenien , perpunimin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te te gjitha artikujve te prodhimeve te detit brenda dhe jashte Shqiperise .Hapjen e ambienteve te bar – restoraneteve , hoteleri , e ambienteve per kryerjen e tregetimit te mallrave . Investimin e fitimeve te shoqerise ne fonde te ndryshme ne Shqiperi dhe jashte saj ."

NENI 5

Shoqeria "ROZAFI" SHPK eshte person juridik shqiptar, cilesi te cilen e fiton ne momentin e Rregjistrimit ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane dhe aktivitetin e saj e fillon menjehere pasi te jete miratuar dhe rregjistruar ne rregjistrin perkates te Gjykatës se Shkalles se Pare Tirane, si dhe ne organet tatimore perkatese. Ajo kryen aktivitetin e saj ne perputhje me me ligjin "Per shoqerite



tregetare" etj dhe te dokumentave te saj themeltare si "STATUTI" I shoqerise dhe "AKTI I THEMELIMIT".

NENI 6

Krijuesi i kesaj shoqerise, Zj. Mimika Luca, merr persiper dhe garanton mardheniet me te tretet, duke respektuar me korrektesi kontratat e lidhura, duke u mbeshtetur ne kapitalin e saj fillestar dhe ne mjetet e tjera te xhiros ne pasuri te lujtshme, qe ka patur deri tani.

Ajo emerom administrator te shoqerise z. Gjergj Luca .

NENI 7

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e saj per nje periudhe mbi 20 vjet, duke filluar nga data e rregjistrimit.

KREU II

Te Drejtat dhe Detyrat e Ortakut te Vetem

NENI 8

Ortaku i vetem, krijues i kesaj shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me nje ortak te vetem eshte Zj. MIMIKA LUCA, e cila me veprime direkte te kryera nga vete ajo, ose duke u perfaqesuar nga persona te tjere te caktuar rregullisht nga ajo si administrator, merr vendime ne keto drejtime:

- 1- Merr pjese dhe drejton te gjithe veprimtarine administrative, ekonomike - financiare dhe juridike te shoqerise, ne respektim te ligjit dhe dispozitave te statutit,
- 2- Grumbullon dhe u jep informacion organeve kompetente ne lidhje me veprimtarine e shoqerise qe drejton, si edhe shlyen detyrimet ndaj ketyre organeve,
- 3- Te krijoje, te mbaje e te plotesoje te gjithe dokumentacionin e nevojshem te shoqerise,
- 4- Te mbaje evidenca ekonomike te shoqerise, te kryeje analizat perkatese dhe te redaktoje bilancet e saj,
- 5- Kur e shikon te arsyeshme, ka te drejte te heqe dore nga zhvillimi i metejshe i aktivitetit te shoqerise, duke e tjetersuar pasurine e saj, plotesisht ose pjeserisht,

NENI 9

Ortaku i vetem ka keto detyra kryesore:

- 1- Te redaktoje statutin dhe dokumentacionet e nevojshme deri ne miratimin dhe rregjistrimin e shoqerise,
- 2- Te derdhe kuoten e caktuar ne masen 100 000 leke, dhe te pajiset me dokumentin e qe e verteton kete derdhje.
- 3- Te drejtoje aktivitetin e shoqerise tregetare me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "ROZAFI" SHPK e cila do te jete shoqeri me nje ortak te vetem, ne perputhje me ligjet qe rregullojne veprimtarine normale te personit "JURIDIK", po ashtu te kete korrektesi ne lidhje me mardheniet e krijuara mes ortakut te vetem dhe personave te punesuar ne shoqeri.



NENI 10

Duke qene ortak i vetem ne shoqeri gezon te drejten per te vendosur mbi vazhdimesi te e aktivitetit ose mundesine e shperberjes se saj te parakohshme, kur ve re se egzistojne kushtet per mbylljen e saj. Ne rast se shoqeria mbyll aktivitetin e saj, te gjitha detyrimet merren persiper nga ortaku i vetem, dhe likujdohen sipas radhes se tyre, ne perputhje me legjislacionin perkates.

KREU III

Kushtet ekonomike te shoqerise

NENI 11

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

E gjithe veprimtaria e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar realizohet mbi bazen e leverdise ekonomike te saj dhe pasqyrohet ne bilancet periodike te saj.

NENI 12

Per zhvillimin normal te veprimtarise ne shoqerine "ROZAFJA" SHPK, vihet ne dispozicion nje kapital baze prej 100 000 lekesh, i cili do te depozitohet ne banke.

Kapitali themelor ose pjese te caktuara te tij jane te transferueshme kundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit tek nje person i trete behet me akt noterial.

Te gjitha veprimet e shoqerise me kapitalin themeltar ne natyre, behen nga ortaku i vetem, ose nga nje ekspert i caktuar prej tij.

NENI 13

Pronar i vetem i te gjitha pasurive qe ka shoqeria eshte Zj. MIMIKA LUCA .

Ajo ka te drejte te kryeje veprime per shtimin e pasurise se shoqerise si ne vlere monetare dhe ne pasuri te tjera te palujtshme dhe te gjitha keto rregjistrohen ne llogarite e kesaj shoqerie.


NENI 14

Me qellim qe te kryhet nje aktivitet normal i shoqerise dhe te kete qendrueshmeri ekonomike, krijohet nje kapital rezerve. Menyra, format dhe perqindja ndaj kapitalit themelor , vendosen nga ortaku i vetem i shoqerise.

Te gjitha mjetet e saj financiare disponohen nga vete shoqeria pa asnje kufizim nga personat e tjere. Detyrimet qe ka shoqeria ndaj personave te tjere, mbulohen nga fondi i saj rezerve dhe nga shuma te tjera suplementare qe mund te depozitohen gjate veprimtarise se shoqerise.

NENI 15

Ne periudha te caktuara te zhvillimit te aktivitetit te shoqerise behet analiza ekonomike. llogariten amortizimet, shpenzimet e ndryshme, pagat e punonjesve , blerjet e bera per nevojat e zhvillimit nrmal te aktivitetit dhe ne perfundim evidentohet shuma e fitimit real te realizuar. Ky fitim i perket ortakut te vetem themelues te shoqerise.



NENI 16

Brenda dates 31 mars te sejcilit vit, behet bilanci vjetor dhe ai paraqitet ne organet kompetente te vendit ku ushtron veprimtarine kjo shoqeri.

NENI 17

Shoqeria e realizon veprimtarine e saj financiare ne baze te planit financiar. Ne te pasqyrohen si aktivi ashtu edhe pasivi i aktivitetit te shprehura ne vlere monetare. Rezultatet financiare te shoqerise tatohen ne baze te bilancit vjetor.

KREU IV

Administrimi i shoqerise

NENI 18

Organi vendimor i shoqerise eshte asambljea e perbere nga ortaku i vetem. Vete themeluesi i kesaj shoqerie ka te drejte te marre dhe vere ne zbatim vendime konkrete. Ai ka te drejte te miratoje bilancin vjetor te aktivitetit, ndryshime dhe shtesa ne dispozitat e statutit, te kapitalit themelor te saj, te gjitha keto ne perputhje me ligjin dhe rregullat baze etj.

NENI 19

Ne krye te shoqerise qendron krijuesi i saj Zj.MIMIKA LUCA , me cilesine e themeluesit dhe ortakut te vetem te shoqerise, e cila e drejton kete veprimtari ne te gjitha drejtimet, merr vendime etj.

Ajo ka te drejten dhe e cakton administratorin e shoqerise per drejtimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per lidhjen e maredhenieve me te tretet .

Administratori cakton vendet e punes, personat e punesuar, dhe te drejttat e detyrimet e te punesuarve bazuar edhe ne legjiatlacianin shqiptar te punes.

NENI 20

Shoqeria cel ne banke numrin e saj te llogarise dhe prane saj depozitohet firma e administratorit, i cili ka te drejte te kryeje veprime ne emer dhe per llogari te administratorit.

NENI 21

Po ashtu pergatitet edhe vula e shoqerise me mbishkrimin SHOQERIA TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "ROZAFI" SHPK, e cila do te perdoret nga shoqeria ne vertetimin te gjitha dokumentave qe do te perpilohen gjate aktivitetit.

NENI 22

Mardheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me nenin 19 te ligjit 7512 date 10.08.1991, duke redaktuar kontratat perkatese per secilin rast.

Ne shoqeri mbahet libri i personelit i cili raportohet periodikisht ne seksionin e punes te Pushtetit Lokal.



KREU V

MBYLLJA E SHOQERISE

NENI 23

Veprimtaria e shoqerise pushon ne mbarim te afatit te percaktuar nga statuti, ne qoftë se ortakut i vetem, me vullnetin e tij te lire nuk e zgjat kete afat.

Ajo mund ta pushoje veprimtarine e saj edhe perpara ketij afati, me propozim te organit administrativ te saj ose, kur per kete merr vendim ortakut i vetem, kur rezultatet financiare jane me humbje dhe nuk mund te perballonen.

NENI 24

Ne rastet kur shoqeria likujdohet plotesisht, ortakut i vetem cakton likujdatorin, i cili paraqet bilancin perkates te likujdimit, moment ne te cilin merr fund perfundimisht aktiviteti i kesaj shoqerie.

E gjithë pasuria e shoqerise i kalon ortakut te vetem pasi jane shlyer te gjitha detyrimet ndaj personave te tjere fizike ose juridike, sipas perkatesise.

Pasuria qe eshte futur ne shoqeri me te drejta shfrytezimi i kthehet pronarit te ligjshem.

NENI 25

Me pushimin e veprimtarise se shoqerise, behet pushimi i veprimtarive te degeve e filialeve saj qe jane celur ne varesi te saj.

KREU VI

Dispozitat e fundit

Neni 26

Themeluesi ne rastin e shtimit te numrit te ortakeve, ka te drejte te beje ndryshimet e nevojshme ne statut, si edhe te hartoje kontraten e perbashket me ortakut e tjere, duke bere ndryshimet e nevojshme ne Rregjistrin Tregetar, prane Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.


NENI 27

Mosmarrveshjet e shoqerise me personat juridike e fizike, vendas a te huaj, zgjidhen me mirekuptim, dhe kur kjo nuk arrihet, zgjidhen ne gjykate.

Gjykata kopetente per zgjidhjen e mosmarrveshjeve eshte Gjykata e Shkalles se Pare Tirane

NENI 28

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut, shoqeria i referohet ligjit "Per Shoqerite Tregetare", si edhe cdo akti tjeter ligjor e nenligjor, me qellim qe te plotesohet kuadri I ketij statuti dhe te sigurohet funksionimi sa me i suksesshem i kesaj shoqerie.



ORTAKU I VETEM
I
Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

Me nje ortak te vetem

"ROZAFA " SHPK

MIMIKA LUCA

Mimika Luca
Mimika Luca